



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 82, 83, 84, 85, 86 dhe nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 08.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 05/2024

THEMELIMI DHE MENAXHIMI I QENDRAVE TË VOTIMIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton kriteret teknike për vendndodhjen e Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendvotimeve (VV), procedurat për themelimin dhe publikimin e QV, menaxhimin e QV, si dhe publikimin e Listës Preliminare të Votuesve (LPV).

Neni 2

Qendrat e Votimit dhe vendndodhja

1. QV – do të thotë ndërtesa ku ndodhet një, apo më shumë VV dhe hapësira e jashtme e saj.
2. QV themelohen në:
 - 2.1. Ndërtesa të institucioneve publike, me prioritet në objektet arsimore, kulturore, sportive dhe të ngjashme;
 - 2.2. në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, për votim jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare.
3. Në rastet kur nuk mund të aplikohet paragrafi 2.1 i këtij neni, KQZ me vendim cakton vendndodhjen e QV në ndërtesa private, në pronësi të personave fizikë ose juridikë, apo hapësira tjera alternative.
4. QV brenda vendit nuk mund të themelohen në objektet:
 - 4.1. Të cilat përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht të një partie politike;

- 4.2. që përdoren ose janë në pronësi të kandidatit apo familjarit të tij për ato zgjedhje;
- 4.3. në objekte fetare;
- 4.4. hapësirat në të cilat shërbehet apo konsumohet alkooli;
- 4.5. hapësirat në të cilat zhvillohen veprimtaritë e lojërave të fatit.
5. Mundësisht, asnjë votues nuk duhet të udhëtojë më shumë se 3 km deri në QV.
6. Ndryshimet e vendndodhjes së QV lejohen nga KQZ, vetëm në rast të forcës madhore ose për shkaqe të tjera objektive dhe të paparashikuara, që do ta bënin një QV të papërshtatshme për qëllime votimi.
7. Nëse vendndodhja e QV ndryshohet, KKZ duhet t'i njoftojë votuesit për atë ndryshim përmes mediave. Përveç kësaj, KKZ do të vendosë një njoftim në lokacionin fillestar të QV, me të cilin i njofton votuesit për lokacionin e ri të QV.

Neni 3

Kriteret teknike për QV dhe VV

1. Objektet e QV duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 1.1. Të ketë së paku një hyrje, e cila duhet të jetë lehtësisht e qasshme;
 - 1.2. të ketë ndriçim të mjaftueshëm;
 - 1.3. të ketë qasje të lehtë për votim të personave me nevoja të veçanta;
 - 1.4. të ketë tavolina dhe karrige;
 - 1.5. të ketë energji elektrike;
 - 1.6. të ketë internet;
 - 1.7. të ketë së paku një tualet;
 - 1.8. për aq sa është e mundur, të ketë hapësirë për parking.
2. Kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni vlejné edhe për QV në përfaqësi diplomatike, për aq sa është e mundur.
3. Kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni vlejné edhe për VV, përjashtimisht nën paragrafi 1.7, dhe 1.8.

Neni 4

Procedurat për themelimin e QV dhe VV

1. KQZ, përmes ZEKKZ dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, kujdeset që një herë në vit të bëjë analizën dhe vlerësimin e QV, dhe mund të propozojë themelimin e QV të reja.

2. Kërkesat për themelimin e QV të reja mund të bëhen nga këshillat lokale, qytetarët apo subjektet politike të ZEKZZ, përmes Shtojca I - Formulari i kërkesës për themelimin e QV.
3. Kërkesën për themelimin e QV, KQZ e shqyrton brenda 10 ditëve, duke pasur për bazë identifikimin e votuesve për atë QV dhe aspektet teknike, sipas nenit 3 të kësaj Rregullore.
4. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike në përputhje me kriteret e përcaktuara, dhe vendosë për numrin e VV dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike, Shtojca III – Formulari i vlerësimit për përfaqësi diplomatike.
5. Jo më vonë se 25 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, KQZ përmes KKZ bën inspektimin dhe vlerësimin e QV dhe VV brenda Kosovës, Shtojca IV – Formulari i inspektimit dhe vlerësimit të QV dhe VV.
 - 5.1. Pesë (5) ditë pas përfundimit të vlerësimit, KQZ e miraton listën e QV dhe VV.

Neni 5

Publikimi i QV

1. Lokacionet e QV publikohen në faqen zyrtare të KQZ, në hapësirat për publikime të KKZ, në faqen zyrtare të komunës, në faqen zyrtare të MPJ për QV jashtë Kosovës, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.
2. Në ato komuna ku zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune, numri i QV dhe lokacionet e tyre janë të njëjta si në raundin e parë.

Neni 6

Menaxhimi i QV

1. Në QV, gjatë ditës së zgjedhjeve, mund të jenë të pranishëm personat e autorizuar, si në vijim:
 - 1.1. Votuesit;
 - 1.2. anëtarët e KVV dhe stafi i QV përkatëse;
 - 1.3. stafi i KQZ dhe SKQZ;
 - 1.4. anëtarët dhe stafi mbështetës i KKZ-së, të komunës përkatëse;
 - 1.5. vëzhguesit e akredituar;
 - 1.6. policia, kur thirret për të vendosur rregull;
 - 1.7. përkthyesit për personat e shënuar në nën paragrafin 1.3., 1.5., 1.6. të këtij neni.
2. Personeli i QV përbëhet nga:

- 2.1. Menaxheri i QV;
- 2.2. personeli i tavolinës ndihmëse.
3. Menaxheri i QV, është përgjegjës për:
 - 3.1. Organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në QV;
 - 3.2. pranimin e pakos së materialeve jo të ndjeshme të QV;
 - 3.3. orientimin, qarkullimin dhe qasjen e votuesve në QV;
 - 3.4. raportimin tek KKZ, për mbarëvajtjen dhe gjendjen në QV;
 - 3.5. evidentimin në librin e evidencës, si Shtojcë V – Libri i evidencave.
4. Pas mbylljes së QV dhe gjatë periudhës së numërimit në VV, Menaxheri i QV sigurohet që të mos jetë prezent asnjë person jashtë VV, përjashtimisht zyrtarët e autorizuar nga KKZ dhe KQZ.

Neni 7

Materiali i fushatës zgjedhore të subjekteve politike në QV dhe VV

1. Së paku 24 orë para fillimit të votimit, menaxheri i QV largon çfarëdo lloj materiali të fushatës zgjedhore nga hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QV, duke përfshirë rrethojat.
2. Subjektet politike të cilat nuk e kanë larguar materialin e fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit, ose janë gjetur duke postuar materialin e fushatës zgjedhore pas afatit kohor të caktuar, evidentohen në librin e evidencës, Shtojca V – Libri i Evidencave dhe raportohen në KKZ.
3. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore të subjekteve politike nuk lejohet të transmetohet nga asnjë pajisje komunikimi në QV dhe as në distancë të dëgjueshme brenda hapësirave të QV. Një veprim i tillë evidentohet në librin e evidencës dhe raportohet në KKZ dhe në organet e rendit nëse është e nevojshme.
4. Në rast se menaxheri konstaton se, në hapësirat e QV qëndrojnë persona të paautorizuar të cilët pengojnë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, atëherë ai kërkon nga të njëjtit që të largohen nga hapësirat e QV dhe në rast të refuzimit, njofton organet e rendit dhe KKZ, rastin e shënon në librin e evidencës.
5. Në rast të raportimit nga menaxheri, sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 të këtij neni, KKZ adreson çështjen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe nëse është e nevojshme, edhe në organet përkatëse të rendit.

Neni 8

Tavolina ndihmëse në QV

1. Në hyrjen kryesore të çdo QV duhet të vendoset së paku një tavolinë ndihmëse që shërben për orientimin dhe informimin e votuesve.
2. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me LV në formatin elektronik.
3. Tavolina ndihmëse duhet të jetë e pajisur me formularët për ankesa dhe parashtrës që i drejtohen PZAP, nëpërmjet të cilave votuesit mund të ankohen në PZAP gjatë ditës së votimit në rast se kanë vërejtje.
4. Çdo QV duhet të ketë personelin e tavolinës ndihmëse, i cili është përgjegjës për:
 - 4.1. Orientimin e votuesve në vendvotime, sipas LPV;
 - 4.2. raportimin e pjesëmarrjes së votuesve;
 - 4.3. raportimin e rezultateve preliminare, bazuar në të dhënat e KVV, sipas udhëzimeve nga KQZ.
5. Në çdo QV duhet të ketë edhe shabllone me alfabetin e brajl-it dhe KVV të trajnuar për votimin e personave të verbër, të cilët do t'u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.

Neni 9

Vendndodhja e VV

1. VV vendosen duke filluar në katin përdhësë, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t'u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.
2. VV duhet të jetë mjaftueshëm i përshtatshëm, që të sigurojë zhvillimin e rregullt të votimit, duke vendosur të gjitha tavolinat e punës ashtu si janë definuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/ 2024 për Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim, duke e siguruar fshehtësinë e votimit, shikimin dhe kontrollin e lirë të kutisë së votimit dhe qasjen e papenguar për vëzhguesit.

Neni 10

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore nr. 05/2023 për Themelimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit, e datës 09.03.2023.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë:
 - 2.1. Shtojca I – Formulari i kërkesës për themelimin e QV;

- 2.2. shtojca II – Formulari për ndryshimin e QV;
- 2.3. shtojca III – Formulari i vlerësimit për përfaqësi diplomatike;
- 2.4. shtojca IV – Formulari i inspektimit dhe vlerësimit të QV dhe VV;
- 2.5. shtojca V – Libri i evidencës.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi